



PËRDORNI TANI SHANSIN TUAJ PËR NJË FILLIM TË RI!

Në qendrën e këshillimit për parandalimin e dhunës, ju do të merrni mbështetje që në të ardhmen të jetoni pa dhunë. Dhuna krijon probleme – edhe për ju. Kjo nuk duhet të jetë kështu.

Në qendrën e këshillimit për parandalimin e dhunës, ne punojmë së bashku me ju për:

- » të ndaluar menjëherë veprimet e dhunës;
- » të gjetur mënyra për të debatuar dhe zgjidhur konfliktet pa përdorur dhunë;
- » të përballuar situatën aktuale të stresit;
- » të sqaruar situatën e banimit pas ndalesës së hyrjes dhe afrimit;
- » të dalë nga rrethi i dhunës.

Ne flasim me ju për pasojat e veprimeve tuaja dhe se si mund të përballeni më së miri me to.

Nëse dëshironi, së bashku gjejmë mundësi shtesë këshillimi me ju.

SA MË POSHTË DUHET TË DINI DHE TË VINI RE

- » Këshillimi për parandalimin e dhunës zgjat 6 orë.
- » Ju caktoni takime me këshilltarin ose këshilltaren tuaj gjatë tetë javëve të ardhshme.
- » Ju jeni të detyruar të merrni pjesë aktive në të gjithë këshillimin.
- » Nëse nuk merrni pjesë në një takim, ju duhet të keni një arsye të mirë për këtë. P.sh. ju jeni i sëmurë. Njoftoni patjetër këshilltarin ose këshilltaren tuaj për këtë.
- » Nëse nuk paraqiteni në takimet e caktuara do të thirreni nga autoritetet e sigurisë dhe mund të merrni një gjobë.
- » Nëse nuk e përfundoni plotësisht këshillimin për parandalimin e dhunës mund të merrni një gjobë.

Këshillimi ynë është konfidencial.

Por ne flasim me institucionet për mbrojtjen e viktimave dhe me policinë, nëse kemi arsye të besojmë se njerëzit janë në rrezik të madh. E bëjmë këtë që ky rrezik të mund të zvogëlohet.

Dhe ne e raportojmë këtë tek autoritetet e sigurisë, nëse ju mungoni në takime pa arsye ose nuk merrni pjesë në mënyrë aktive në të gjithë këshillimin për parandalimin e dhunës. Ne jemi të detyruar ta bëjmë këtë.

ÇFARË DUHET TË DINI GJITHASHTU PËR NDALIMIN E HYRJES DHE AFRIMIT

- » Ndalimi i hyrjes dhe afrimit vlen për 14 ditë. Gjatë kësaj kohe nuk ju lejohet të hyni në banesën e mbrojtur dhe duhet të mbani një distancë prej 100 metrash nga ajo.
- » Nuk ju lejohet t'i afroheni personit ose personave të mbrojtur më afër se 100 metra. Kjo vlen edhe nëse një person i mbrojtur dëshiron të takohet me ju.
- » Ndalimi i hyrjes dhe afrimit mund të zgjatet nëpërmjet një kërkesë për një urdhër të përkohshëm mbrojtje nga gjykata. Ju do të informoheni në lidhje me këtë. Informacionin do ta merrni në vendin e dorëzimit që keni dhënë.



ÇFARË DUHET TË BËNI PARA SE TË KTHEHENI NË BANESË

- » Ju lutemi, merrni çelësin në polici. Atje do të informoheni gjithashtu nëse ndalimi i hyrjes dhe afrimit është zgjatur përmes një kërkesë për një urdhër të përkohshëm mbrojtjeje nga gjykata.
- » Ndoshta ndalimi i hyrjes dhe afrimit është zgjatur. Atëherë nuk ju lejohet ende të ktheheni në banesë. Informacione rreth kësaj mund të gjeni edhe në vendin e dorëzimit që keni dhënë në polici.
- » Njoftoni bashkëbanueset dhe bashkëbanuesit para se të ktheheni në banesë. Kjo është nisja më e mirë për një fillim të ri!

Niseni ju bisedën.

Nisni me ne një fillim të ri!